



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Kosova Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 325/26 Dt. 16.07.2026



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren
Prizren Belediyesi

**Procesverbali i përgjithshëm i dëgjimeve buxhetore të
organizuara gjatë vitit 2026 për buxhetin e vitit 2027 dhe
planifikimet për vitet 2028/2029**

Procesverball nga mbajtja e dëgjimit publik me Qytetarë, Kryetarë/e të këshillave të lagjeve dhe fshatrave të Komunës së Prizrenit për hartimin e buxhetit për vitin 2027 dhe KAB 2028/2029.

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028–2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrim të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij takimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Prizrenit për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioriteteve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **24:06.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/1-Njoftim-per-Degjim-publik-me-Qytetare-Kryetare-e-te-keshillave-te-lagjeve-dhe-fshatrave-te-Komunes-se-Prizrenit.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-me-qytetare-kryetare-e-te-keshillave-te-lagjeve-dhe-fshatrave-te-komunes-se-prizrenit-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2027-dhe-kab-2028-2029/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/18k8tLW7A3/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Memorandum-Shpjegues-1.pdf>

Takimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën **10:15**.

Hapja e dëgjimit e dëgjimit publik është bërë nga Ymer Berisha, udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun i cili tha se ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë Dëgjim Publik, i cili organizohet në kuadër të procesit të hartimit të Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2028–2029.

Roli juaj si përfaqësues të drejtpërdrejtë të qytetarëve është i një rëndësie të veçantë në këtë proces, pasi ju njihni nga afër nevojat, kërkesat dhe prioritetet e lagjeve dhe fshatrave që përfaqësoni. Përmes këtij takimi synojmë të dëgjojmë propozimet tuaja, të diskutojmë për projektet prioritare dhe të sigurohemi që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komuniteteve lokale.

Buxheti komunal është dokumenti më i rëndësishëm zhvillimor i komunës. Përmes tij planifikohen investimet kapitale dhe financohen shërbimet publike që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve. Prandaj, kontributi juaj në këtë fazë të planifikimit është thelbësor për përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit të Komunës së Prizrenit.

Të gjitha propozimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë këtij dëgjimi publik do të evidentohen dhe do të shqyrtohen nga ekipi përgjegjës për hartimin e buxhetit, në përputhje me mundësitë financiare, prioritetet strategjike të komunës dhe legjislacionin në fuqi.

Ju ftoj që gjatë këtij takimi të paraqisni propozimet dhe vërejtjet tuaja në mënyrë konkrete dhe konstruktive, me qëllim që së bashku të hartojmë një buxhet sa më gjithëpërfshirës, të balancuar dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

Prezantimin e propozim-buxhetit për vitin 2027 e bëri Zyrtaari Kryesor Financiar, Lulzim Sylejmani. Gjatë prezantimit, ai paraqiti kategoritë kryesore të shpenzimeve të planifikuara, duke theksuar se buxheti është hartuar në përputhje me prioritetet zhvillimore dhe nevojat e qytetarëve të Komunës së Prizrenit.

Sipas prezantimit, për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar 33,885,952 euro, për mallra dhe shërbime 15,230,224 euro, për shpenzime komunale 1,205,299 euro, për subvencione 5,531,785 euro, ndërsa për investime kapitale janë paraparë 23,235,681 euro.

Sylejmani bëri të ditur se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 është planifikuar në vlerë prej 79,118,941 euro. Ai theksoi se ky planifikim buxhetor synon të mbështesë ofrimin e shërbimeve cilësore publike, realizimin e projekteve prioritare dhe investimeve që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik e shoqëror të komunës, duke përmirësuar mirëqenien dhe cilësinë e jetës së qytetarëve.

Kërkesat e qytetarëve:

Faik Berisha, kryetar i këshillit të fshatit Landovicë.

- 1.Regullimi i një nënkalimi për kyçe nga fshati në rrugën regjionale.
- 2.Evitimi i problemeve që po vijnë nga biyeneset që kanë lokale tek rreth rrotullimi, kanalizimet po derdhen në fshat.
- 3.Dezinsektimi i fshatit.

Enxhell Kajtazi, banor i fshatit Karashëngjergj.

- 1.Ndërtimi i një fushe sportive në fshat.

Shani Tanaj, kryetar I këshillit lokal të fshatrave Mazrrek, Kojushl, Planejë dhe Gorizhup.

Mazrrek:

- 1.Regullimi i rrugëve lokale.
- 2.Ndriçimin publik .
- 3.Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve lokale.

Kojushë:

- 1.Regullimin e rrugëve lokale.
- 2.Regullimin e ndriçimit publik në fshatin.
- 3.Regullimi i kanalizimit nëpër disa lagje të fshatit.

Planejë:

- 1.Regullimi i rrugëve lokale.
- 2.Regullimi i ndriçimit publik.
- 3.Regullimi i kanalizimit në disa lagje.

Gorozhup:

- 1.Regullimin e rrugëve lokale.
- 2.Regullimi i ndriçimit publik.
- 3.Regullimi i kanalizimit ne disa lagje.

Dashmor Susuri, kryetar i këshillit të lagjes “Bajram Curr”

- 1.Probleme me furnizim me ujë në lagje.
- 2.Ndertimi i një aneksti të shkollës “Fatmir Berisha”
- 3.Pagesa e rrugës për nxënësit që udhëtojnë.
- 4.Probleme me qenë endacak.
- 5.Regullimi i ndriçimit publik.
- 6.Regullimi i kanalizimit.
- 7.Kubëzimi i rrugëve në lagje.
- 8.Regullimi i rrugës që lidh lagjen “Bajram Curr” me fshatin Kobaj.
- 9.Ndërtimi i një parku në lagje.

Bedri Çeku, banor i lagjes “Vëllëzërit Stavileci” në Prizren.

- 1.Ndërrimi i gypave të ujit.
- 2.Regullimi i ndriçimit publik.
- 3.Riparimi i rrugëve të dëmtuara.
- 4.Rrënimi i një objekti të vjetër në lagje.

Bekim Nerjova, banor i fshatit Lubizhd-Has.

- 1.Nderimi i rrugës Dedaj-Lubizhdë.
- 2.Regullimi i trotuareve.
- 3.Kubëzimi i rrugëve.
- 4.Regullimi i shtratit të lumit.
- 5.Renovimi i shtëpisë së kulturës.

Simon Veseli, kryetar i këshillit të fshatrave Velezhë, Sërbicë e Epërme, Trepeticë, Shpenadi dhe Smaq.

- 1.Regullimi i shtratit të lumit.
- 2.Regullimi i ndriçimit publik në fshatin Shpenadi.
- 3.Kubëzimi i rrugëve në fshatin Shpenadi.
- 4.Regullimi i ndriçimit publik në fshatin Velezhë.
- 5.Kubëzimi i rrugëve në fshatin Velezhë.
- 6.Regullimi i rrugës nga fshati Smaq për në Mamushë.
- 7.Regullimi i rrugëve fushore.

Shukri Quni, kryetar i këshillit të fshatrave Nashec-Grazhdanik.

- 1.Ndërtimi i rrugës për Nashec.
- 2.Hartimi i projektit për impiantin e ujërave të zeza në Nashec.
- 3.Asfaltimi i rrugës Nashec-Tupec.
- 4.Asfaltimi i rrugëve në Nashec
- 5.Vendosja e mbrojtëseve përgjatë rrugëve.
- 6.Ndërrimi i gypit të ujit.
- 7.Regullimi i rrugëve fushore.
- 8.Regullimi i një fushe sportive.
- 9.Renovimi i kulmit të shkollës në fshatin Nashec.

Besmir Shala, kryetar i këshillit të fshatit Billush.

- 1.Regullimi i ujit të pijes.
- 2.Regullimi i kanalizimit.
- 3.Vazhdimi i punimeve për rrugën që të dërgon në fshatin Billushë.

Bujar Pulaj, kryetar i këshillit të fshatrave: Vermicë, Shkozë dhe Dobrusht.

1.Vazhdimi i projektit-Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e ujëmatësve jashtë pronave private, ky projekt të realizohet në 3 fshatrat.

Vërmicë:

2.Regullimi i ndriçimit publik.

3.Regullimi i mureve mbrojtëse.

4.Regullimi i trotuarit përgjatë rrugës magjistrale-Kukës-Prizren rreth liqenit.

Shkozë:

5.Regullimi i kanalizimit për tek shkolla fillore.

6.Regullimi i disa rrugëve të fshatit me kubëza.

Dobrusht:

8.Regullimi i një rezervari të ujit të pijes.

9.Regullimi i disa rrugëve me kubëza.

10.Regullimi i kanalizimit në disa pjesë të fshatit.

11.Regullimi i ndriçimit në fshat për pjesët ku nuk ka ende ndriçim.

Samedin Maçkaj, banor i fshatit Lubeqevë.

1.Regullimi i një fushe të futbollit në fshatin Lubeqevë.

2.Vazhdimi i punimeve në rrugën Lubeqevë-Lez.

3.Regullimi i rrugës që dërgon tek shkronjat e UÇK-së.

4.Mirëmbajtja dhe rregullimi i rrugëve në fshat.

Herolind Osmanollaj, kryetar i këshillit të fshatrave Gjonaj-Tupec.

Gjonaj:

1.Regullimi i rrugës kryesore Gjonaj-Mazrrek.

2.Regullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale.

3.Ndërtimi i trotuareve në zonat me frekuentim të lartë të këmbësorëve.

4.Ndërtimi i mureve mbrojtëse në pikat ku paraqitet nevoja.

5.Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekal dhe atmosferik.

6.Renovimi i Qendrës Kulturore "Reshat Çoçaj".

7.Ndërtimi i një çerdheje publike në fshatin Gjonaj për nevojat e rajonit të Hasit.

8.Hartimi i projektit për komasacionin dhe zhbllokimi i rreth 100 hektarëve tokë bujqësore në pjesën jugore të fshatit Gjonaj.

9.Pastrimi dhe rehabilitimi i vijës ekzistuese të kullimit të tokave bujqësore në aksin Landovicë-Gjonaj.

10.Vendosjen e Kamerave në fshatin Gjonaj, Drejtorise së Emergjencave dhe Sigurisë.

Tupec:

- 1.Ndriçimit publik në tërë fshatin Tupec.
- 2.Ndërtimi i trotuarit përgjatë SHFMU Zenun Çoçaj, për sigurinë e nxënësve dhe këmbësorëve.
- 3.Ndërtimi i sistemit të kanalizimit fekal dhe atmosferik.
- 4.Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale.

Ajet Shala, kryetar i këshillit të fshatit Atmaxhë.

- 1.Rregullimi i trotuareve në fshat.
- 2.Rregullimi i ndriçimit publik.
- 3-Rregullimi i rrugëve fushore.

Ismet Rustemovic, kryetar i fshatit Reqanë

- 1.Ndërtimin e mureve mbrojtëse në shtratin e Lumit.

Halid Karadolami, kryetar i këshillit të fshatit Lubinje e Poshtme, Lubinje e Epërme dhe Drajqiç.

- 1.Nderimi i një muri mbrojtës në fshatin Lubinjë e Poshtme.
- 2.Ndërtimi i një rruge fushore me gjatësi prej 400 metrave në fshatin Lubinjë e Poshtme.

Behajdin Berisha, banor i lagjës Tusus, rruga "Naip Berisha".

- 1.Eregullimi i rruges e cila është demtuar në mase të mëdha.
- 2.Rregullimi i sistemit të ujit të pijës

Takimi ka përfunduar në orën 11:10.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, Projekt Buxheti u janë shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në dëgjim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën dëgjim publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> : <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Me 08.07.2026, është mbajtur takimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e dëgjimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjim-publik-me-qytetare-kryetare-te-keshillave-te-lagjeve-dhe-fshatrave-te-komunes-se-prizrenit-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2027-dhe-kab-2028-2029/>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1DVCsNtgYx/>

Procesverbali nga mbajtja e dëgjimit publik me Personelin shëndetësor dhe drejtorë/esha të shkollave të Komunës së Prizrenit

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028–2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrit të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij takimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Prizrenit për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioritetëve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **26:06.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/2-Njoftim-per-Degjim-publik-me-Personelin-shendetesor-dhe-drejtore-eshate-shkollave-te-Komunes-se-Prizrenit.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjimit-publik-me-personelin-shendetesor-dhe-drejtore-eshate-shkollave-te-komunes-se-prizrenit-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2027-dhe-kab-2028-2029/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1CMHg5nzkl/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Memorandum-Shpjegues-2.pdf>

Dëgjimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën **10:10**.

Hapjen e dëgjimit publik e bëri Ymer Berisha, Udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi për pjesëmarrjen në këtë proces të rëndësishëm konsultativ. Ai theksoi se ky është dëgjimi i dytë publik që organizohet në kuadër të hartimit të buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028–2029.

Gjatë fjalës së tij, ai nënvizoi se organizimi i dëgjimeve publike ka për qëllim të sigurojë përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në procesin e planifikimit buxhetor, duke krijuar mundësi që kërkesat, propozimet dhe prioritetet e tyre të dëgjohen dhe të shqyrtohen nga institucionet komunale.

Ai gjithashtu bëri të ditur se të gjitha propozimet dhe rekomandimet e paraqitura gjatë këtij dëgjimi do të evidentohen dhe do të trajtohen nga drejtoritë përkatëse, në përputhje me prioritetet e komunës dhe mundësitë buxhetore, me synim hartimin e një buxheti sa më gjithëpërfshirës dhe në shërbim të nevojave të qytetarëve.

Prezantimin e propozim-buxhetit për vitin 2027 e bëri Zytari Kryesor Financiar, Lulzim Sylejmani. Ai prezantoi strukturën e buxhetit, duke bërë të ditur se për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar 33,885,952 euro, për mallra dhe shërbime 15,230,224 euro, për shpenzime komunale 1,205,299 euro, për subvencione 5,531,785 euro, ndërsa për investime kapitale 23,235,681 euro.

Sylejmani theksoi se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 është planifikuar në vlerë prej 79,118,941 euro. Sipas tij, ky planifikim buxhetor synon të sigurojë funksionimin e qëndrueshëm të administratës komunale, përmirësimin e shërbimeve publike dhe realizimin e projekteve prioritare në të gjithë territorin e komunës.

Një vëmendje e veçantë, sipas tij, i është kushtuar sektorëve të arsimit dhe shëndetësisë, përmes planifikimit të investimeve që synojnë përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe objekteve shëndetësore, krijimin e kushteve më të mira për nxënësit, mësimdhënësit, pacientët dhe personelin shëndetësor, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve.

Informata shpeshë lidhur me planifikimet buxhetore u dha nga drejtori i Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave, Levent Bush. Ai theksoi se Komuna e Prizrenit po përballet me sfida financiare, si pasojë e ekzekutimit të një pjese të buxhetit përmes procedurave përmbarimore, gjë që ndikon në realizimin e projekteve të planifikuara.

Megjithatë, drejtori Bush u shpreh se, pavarësisht këtyre vështirësive, Komuna do të angazhohet maksimalisht për të realizuar projekte që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së infrastrukturës publike, me fokus të veçantë në objektet arsimore dhe ato shëndetësore.

Ai shtoi se investimet në këta sektorë mbeten prioritet, me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për nxënësit, personelin arsimor, pacientët dhe stafin shëndetësor.

Kërkesat e qytetarëve:

Behare Kryeziu, Drejtoreshë e SHFMU "Mustafa Bakiu"-Prizren

1. Rregullimi i rrethojës së shkollës.
2. Rregullimi dhe renovimi i fushës sportive.
3. Ndërrimi i dritareve dhe dyerve të shkollës.
4. Sigurimi i një punëtorie për mjeshttrin e shkollës.
5. Sanimi i plotë i kulmit të shkollës.
6. Eliminimi i lagështisë në katin përdhese.
7. Realizimi i projektit për rregullimin e oborrit të shkollës.

Mimozë Duraj, Drejtoreshë e shkollës SHFMU "Xhevat Berisha"-Prizren

1. Rrethimi i fushës sportive dhe vendosja e rrjetës mbrojtëse.
2. Renovimi i kulmit të objektit shkollor.
3. Zëvendësimi i dyerve dhe dritareve të amortizuara.
4. Pajisja e kabineteve mësimore me inventar dhe mjete bashkëkohore didaktike
5. Pajisja e shkollës me inventar të ri shkollor.
6. Rregullimi i oborrit të shkollës, gjelbërimi dhe krijimi i hapësirave rekreative.

Myvedete Gavazaj, drejtoreshë në IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren.

1. Renovimi i kulmit të objektit shkollor.
2. Zëvendësimi i dyerve dhe dritareve të amortizuara.
3. Zëvendësimi i ngrohjes qendrore të shkollës.
4. Rregullimi i fasades së shkollës.
5. Rrethimi i fushës sportive dhe vendosja e rrjetës mbrojtëse.

Luljeta Gavaza, drejtoreshë në shkollën "Naim Frashëri" në fshatit Vlashnje.

1. Rregullimi i nxehjes në shkollë.
2. Rregullimi i pompës termike.

Hamz Destani, drejtor i shkollës "Sinan Thaqi" në fshatin Zojz.

1. Rregullimi i urës në fshatin.
2. Rregullimi i mureve mbrojtës.
3. Zgjerimi i hapësirave/oborrit të shkollës.
4. Renovimi i fushës sportive në fshat.

Pjeter Perlazu, koordinator në shkollën e mjekësisë.

1. Evitimi i problemeve me ujë të pijes, hapja e një pusi.
2. Rregullimi i klimatizimit.
3. Nxemja të bëhet me pelet ose me pomp termike.
4. Furnizimi me tabela digjitale.
5. Lyerja e objektit të shkollës.

Rajma Sagdati, drejtoresha e shkollës “Meto Bajraktari” në Reqan.

1. Investime te përgjithshme ne objektin shkollor
2. Rrënimin e shkollës se vjetër për shkak re rrezikshmërisë

Venera Zhubi, drejtoreshë e shkollës “Hasim Maliqaj” në Poslisht.

1. Rregullimi i një terreni sportiv.

Fadil Bajraktari, drejtor i QKMF-Prizren

1. Ndarja e një shume buxhetore për zyrtaret te cilët po pensionohen
2. Parkingu afër QKMF-së të rrethohet dhe të jepet në shfrytëzim për stafin.

Lumnije Rakaj, drejtoreshë në ShMU “ Hysen Rexhepi” – Prizren

1. Ndërtimi i një aneksi të ri me të paktën 18 hapësira mësimore.
2. Rregullimi dhe sistemimin e oborrit të shkollës.
3. Gërryerjen, suvatimin dhe gëlqerosjen e klasave në objektin ekzistues

Dëgjimi ka përfunduar në orën 11:03.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, dokumenti i Qarkores Buxhetore dhe Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) u janë shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në dëgjim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën degjime publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> : <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Me 10.07.2026, është mbajtur dëgjimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e dëgjimi:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjim-publik-me-personelin-shendetesor-dhe-drejtores-eshate-shkollave-te-komunes-se-prizrenit/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1RVrJX9sw6/>

Procesverball nga mbajtja e Dëgjimit Publik-Buxhetimi Gjnorë, përfaqësues të OJQ-ve, të rinjë/ja, pensionist/e, fermerë/e, dhe përfaqësues/e të bizneseve për hartimin e Buxhetit për vitin 2027 dhe KAB-in për vitet 2028/2029

Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për vetëqeverisjen lokale, transparencën publike dhe menaxhimin e financave publike, si dhe në funksion të sigurimit të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse, u mbajt dëgjimi publik për shqyrtimin dhe diskutimin e Buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) për periudhën 2028-2029. Qëllimi i këtij dëgjimi publik ishte informimi i qytetarëve dhe palëve të interesit mbi orientimet kryesore buxhetore të komunës, si dhe mbledhja e propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të tyre në funksion të planifikimit sa më transparent, efikas dhe gjithëpërfshirës të buxhetit komunal dhe dokumenteve strategjike financiare.

Ky procesverbal hartohet me qëllim të dokumentimit të rrjedhës së dëgjimit publik, evidentimit të pjesëmarrjes së palëve të interesit, si dhe pasqyrit të kontributit të qytetarëve përmes propozimeve, sugjerimeve dhe vërejtjeve të paraqitura gjatë këtij dëgjimi, duke shërbyer njëkohësisht si mjet zyrtar i transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike. Dokumentimi i këtij procesi synon të sigurojë që të gjitha çështjet e ngritura nga pjesëmarrësit të evidentohen dhe të trajtohen në mënyrë të duhur gjatë fazës së përgatitjes së draft-buxhetit final dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore 2028–2029.

Dëgjimi publik u mbajt në kuadër të angazhimeve të Komunës së Prizrenit për përfshirjen e qytetarëve në procesin e planifikimit buxhetor dhe për forcimin e transparencës institucionale, duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë ndërmjet administratës komunale dhe komunitetit. Përmes këtij procesi u synua identifikimi i prioriteteve zhvillimore të qytetarëve në fusha të ndryshme si infrastruktura, arsimi, shëndetësia, shërbimet publike dhe zhvillimi ekonomik lokal, me qëllim që planifikimi buxhetor të reflektojë sa më mirë nevojat reale të komunitetit.

Publikimet:

Publikimet janë bërë me **01:07.2026** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/3-Njoftimi-per-Degjim-Publik-Buxhetimi-Gjinore-perfaeqsues-te-OJQ-ve-te-rinje-reja-pensionist-e-fermere-e-dhe-perfaeqsue.pdf>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/njoftim-per-organizimin-e-degjit-publik-per-buxhetimin-gjinore-perfaeqsues-e-te-ojq-ve-te-rinje-reja-pensioniste-e-fermere-e-dhe-perfaeqsues-e-te-bizneseve-te-komunes-se-prizrenit-per-hartimin-e/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/1EshzM158B/>

Memorandumi shpjegues:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/Memorandum-Shpjegues-3.pdf>

Degjimi është mbajtur në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit dhe ka filluar në orën 10:13.

Hapja e dëgjimit publik për Buxhetimin Gjinator, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave joqeveritare (OJQ), të rinjeve, pensionistëve, fermerëve dhe përfaqësuesve të bizneseve, u bë nga Ymer Berisha, Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun. Ai theksoi se ky është dëgjimi i tretë publik që organizohet në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028-2029.

Berisha njoftoi të pranishmit se Komuna e Prizrenit është e përkushtuar për të zhvilluar një proces transparent, gjithëpërfshirës dhe të hapur të planifikimit buxhetor, ku secili qytetar dhe çdo grup i interesit ka mundësinë të paraqesë kërkesat, propozimet dhe prioritetet e veta. Ai theksoi se të gjitha propozimet e paraqitura gjatë dëgjimeve publike do të evidentohen dhe do t'u përcillen drejtorive përkatëse për shqyrtim, në përputhje me mundësitë buxhetore dhe prioritetet zhvillimore të komunës.

Gjatë fjalës së tij, Berisha theksoi gjithashtu se ky proces i dëgjimeve publike gëzon mbështetjen e plotë të Kryetarit të Komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, i cili ka kërkuar që planifikimi i buxhetit të bazohet në nevojat reale të qytetarëve dhe në pjesëmarrjen aktive të tyre.

Në këtë frymë, ai i ftoi të gjithë pjesëmarrësit të kontribuojnë me ide dhe propozime konkrete, duke theksuar se vetëm përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve mund të hartohet një buxhet sa më i drejtë, zhvillimor dhe në interes të të gjithë banorëve të Komunës së Prizrenit.

Prezantimin e propozim-buxhetit të Komunës së Prizrenit për vitin 2027 dhe planifikimeve buxhetore për vitet 2028-2029 e bëri Lulzim Sylejmani, Zyrtar Kryesor Financiar. Ai njoftoi të pranishmit se hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe i projektbuxhetit është bazuar në Qarkoren e Parë Buxhetore për vitin 2027, të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila përcakton kufijtë fillestarë buxhetorë dhe orientimet kryesore për planifikimin e buxheteve komunale.

Sylejmani theksoi se buxheti i planifikuar për vitin 2027 është ndarë sipas kategorive ekonomike, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe prioritetet e përcaktuara nga komuna. Sipas prezantimit, për kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë planifikuar 33,885,952 euro, për mallra dhe shërbime 15,230,224 euro, për shpenzime komunale 1,205,299 euro, për subvencione dhe transfere 5,531,785 euro, ndërsa për investime kapitale 23,235,681 euro.

Ai bëri të ditur se buxheti i përgjithshëm i Komunës së Prizrenit për vitin 2027 është planifikuar në vlerë prej 79,118,941 euro, duke theksuar se ky buxhet synon të mbështesë funksionimin e administratës komunale, përmirësimin e shërbimeve publike dhe realizimin e projekteve zhvillimore në interes të qytetarëve.

Gjithashtu, u sqarua se planifikimet për vitet 2028–2029 janë hartuar në përputhje me parashikimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe mund të pësojnë ndryshime në varësi të qarkoreve të ardhshme buxhetore, nivelit të të hyrave dhe prioritetëve strategjike të Komunës së Prizrenit.

Gjatë prezantimit u theksua rëndësia e dëgjimeve publike, pasi propozimet dhe rekomandimet e qytetarëve do të shqyrtohen dhe, kur janë të realizueshme, do të reflektohen në procesin e finalizimit të projektbuxhetit.

Kërkesat e qytetarëve:

Tringa Kasemi, OJQ “Qendra për Barazi dhe Drejtësi”.

1. Planifikimi i buxhetit për buxhetin gjinorë.
2. Rritja e stafit në Qendrën për Punë Sociale.
3. Rritja e Qendrave të Punësimit.
4. Furnizimi me peceta në shkolla dhe administratë komunale.
5. Grandet që jepen nga komuna të ndahen në mënyrë të barabartë.
6. Rregullimi i ndriçimit publik.
7. Gjatë planifikimit të projekteve të planifikohen edhe për persona me nevojë të veçanta.
8. Të krijohen politika të reja për vajza që merren me sport.

Arben Berisha-Asambleja e Fëmijëve.

1. Kërkesë për takim me kryetarin e komunës.
2. Të krijohet linjë e veçantë për Asamblen e Fëmijëve.
3. Të ndertohen me shume terene per aktivitete sportive
4. Rregullimi dhe mirembajtja e shkollave per nje ambient me te mire per mesim.
5. Të gjitha vendimet që merren në asamble të jenë të pranishme edhe asambleja e fëmijëve.

Fatmir Menekshe, OJQ “Dermish Asllano”.

1. Pagesa e subvencioneve për vitin 2025
2. Ndarja e fondeve të veçanta për shënimin e ditëve të komuniteteve që jetojnë në komunën e Prizrenit.
3. Shtimi i stafit në komunën e Prizrenit për një përkthyes rom.

Krasniqi, shoqata “Hader”.

1. Përkrahja financiare për shoqatën “Hader”.

Dëgjimi ka përfunduar në orën 11:10.

Për të siguruar transparencë dhe informim të plotë të publikut, dokumenti i Qarkores Buxhetore dhe Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) u janë shpërndarë në formë fizike të gjithë pjesëmarrësve në degjim. Njëkohësisht, këto dokumente janë publikuar në faqen zyrtare dhe kanë qenë të qasshme për të gjithë qytetarët përmes vegëzave përkatëse:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën konsultim publik dhe financat: <https://prizren.rks-gov.net/konsultimet-publike/> , <https://prizren.rks-gov.net/financa/> dhe <https://prizren.rks-gov.net/qarkorja-buxhetore/> : <https://prizren.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=projekt-buxheti> .

Me 15.07.2026, është mbajtur degjimi publik, vegëza e publikimit të lajmit për mbajtjen e degjimit:

Në webfaqe:

<https://prizren.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjim-publik-per-buxhetimin-gjinor-perfaqesues-te-ojq-ve-te-rinj-pensioniste-fermere-dhe-perfaqesues-te-bizneseve-per-hartimin-e-buxhetit-per-vitin-2027/>

Facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/1Bm88FHbjF/>

Procesmbajtës:

Gjafer Ponik

Haziz Krasniqi